

DHOMA E POSAÇME E
GJYKATËS SUPREME TË
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE
QË LIDHEN ME
AGJENCINË KOSOVARE
TË MIRËBESIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE
SUPREME COURT OF
KOSOVO ON KOSOVO
TRUST AGENCY RELATED
MATTERS

POSEBNA KOMORA
VRHOVNOG SUDA
KOSOVA ZA PITANJA
KOJA SE ODNOSE NA
KOSOVSKU
POVERENIČKU
AGENCIJU

ASC -10-0023

Në kontestin gjyqësor të

Paditësit/Ankuesit

1. [REDACTED]
2. [REDACTED]
3. [REDACTED]
4. [REDACTED]

të gjithë nga [REDACTED] Gllgovc
të përfaqësuar nga [REDACTED], Avokat
Rr. [REDACTED] Prishtinë

vs.

E Paditura

NSH, [REDACTED] Gllgovc

Kolegji i Ankesave pran Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), në përbërja nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, sipas Ankimit të Paditësve kundër vendimit të DHPGJS-së së datës 21 janar 2010, SCC-09-0040, pas seancës vendim-marrëse të mbajtur me 17 qershor 2010 lëshon këtë

AKTVENDIM

1. Ankimi deri me tani është i bazuar, meqë Pika 1 e vendimit të DHPGJS-së e datës 21 janar 2010, SCC-09-0040, anulohet.

II

2. Trupit Gjykses urdhërohet ta rigjkon padinë.

3. Pika 2 e vendimit eliminohet.

4. Ankuesit obligohen që bashkërisht ti paguajnë shpenzimet gjyqësore në shumë prej 60 Euro për procedurën ankimore në Dhomën e Posaçme.

5. Trupi Gjykses duhet të vendosë në shumën e shpenzimeve në procedurën e shkallës së parë dhe ndarjen e tyre midis palëve, si dhe ndarjen e shpenzimeve të procedurës ankimore.

Arsyetimi Ligjor:

Me 19 mars 2009 (data e pranimit) Avokati [REDAKTUAR] në emër të katër paditësve ka parashtruar padi pranë DHPGJS-së, duke e konsideruar shpronësimin e vitit 1953 si të paligjshëm të ngastrës tokësore me sipërfaqe prej [REDAKTUAR] nga "Paditësit dhe paraardhësit e tyre", e cila gjendet në zonën kadastrale të [REDAKTUAR] Komuna e Gllgovcit, dhe kanë kërkuar që të vërtetohen se Paditësit janë pronarë", ose që e paditura të obligohet ti kompensoi ata me "tokë të kualitetit të njëjtë" ose me para sipas tregut aktual". (në alternativë) ata kërkojnë që e paditura të obligohet që "t'ua transferojë..të drejtën e pronësisë në mënyrë që t'ua mundësoi të njëjtëve regjistrimin si pronarë të ligjshëm". Autorizimi, që mban vetëm nënshkrimin e paditësit të dytë dhe të tretë, dhe përkthimi i tij në Anglisht, si dhe një kopje në Shqip e njoftimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me vulë pranimi të datës 19 mars 2009, iu kishin bashkangjitur padisë.

Me 6 maj 2009, DHPGJS e ka lëshuar një urdhër duke kërkuar nga Paditësit që brenda 14 ditëve nga pranimi i urdhrit ta precizojnë padinë e tyre rreth çështjeve të ndryshme. Me 26 maj 2009, ata (me kohë) iu kanë përgjigjur me një parashtresë vetëm në gjuhën Shqipe.

Me 7 tetor 2009, DHPGJS ka lëshuar një tjetër urdhër, kësaj radhe duke kërkuar nga Paditësit që brenda të njëjtit afat t'ia sigurojnë Gjykatës përkthimin në Anglisht të parashtresës së mëhershme, përkthimin e njoftimit dhe në APK-së të datës 19 mars 2009, dhe (kopjen e vërtetuar) të autorizimit të nënshkruar nga të gjithë Paditësit.

III

Me 29 tetor 2009, Paditësit iu kanë përgjigjur urdhrin dhe e kanë dërguar përkthimin e parashtrësës së mëhershme (lidhur me meritën e lëndës) dhe një kopje të të njëjtit autorizim, por kësaj radhe me dy nënshkrime tjera në origjinal. Paditësit nuk kanë sjellë dokumentacion tjetër, e posaçërisht përkthimin e njoftimit; ata, prapëseprap, kërkonin nga DHPGJS që "tua përkthejnë këtë parashtrësë me shpenzime të saj, meqë pala në fjalë është në gjendje të vështirë financiare". Paditësit nuk e kanë dërguar formularin zyrtar ZPF1.

Me 9 nëntor 2009, DHPGJS e ka lëshuar urdhrin e tretë, me të cilin kërkohet nga Paditësit që brenda 14 ditëve nga pranimi i tij ti dërgojnë: një kopje të autorizimit më të cilin atij i epet autorizim që ti përfaqësojë Paditësit në procedurën para DHPGJS-së, meqë "autorizimi i dërguar është i përgjithshëm dhe pa datë". i cili do të duhej referuar objektit specifik të padisë, dhe përkthimin e tij në Anglisht.

Avokati i Paditësve [REDACTED] e ka pranuar urdhrin me 12 nëntor 2009.

Me parashtrësën e datës 24 nëntor 2009 (të postuar me 29 nëntor 2009, dhe të regjistruar në Dhomën e Posaçme me 30 nëntor 2009) [REDACTED] duke vepruar në emër të Paditësve ka dhënë përgjigje në urdhër, duke e bashkëngjitur një kopje të autorizimit të dërguar me 29 tetor 2009.

Me vendimin e atakuar të datës 21 janar 2010, Trupi Gjykses i DHPGJS-së (1) e ka refuzuar padinë në bazë të papranueshmërisë, dhe (2) iu ka referuar Nenit 9.5 të RREG së UNMIK-ut 2008/4 lidhur me të drejtën e ankimit kundër vendimit. Trupi Gjykses ka argumentuar se Paditësit nuk iu kanë përmbajtur urdhrin të përsëritur të Gjykatës duke kërkuar autorizimin, plotësimin e të gjitha kërkesave të parashtruara në urdhër të datës 9 nëntor 2009: "... autorizimi i dërguar është i njëjti, i përgjithshëm (pa datë) madhe në gjuhën Shqipe". Përfundon se padia duhet të jetë e pranueshme vetëm nëse ajo i plotëson të gjitha kërkesat e Nenit 28.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, gjë që nuk janë plotësuar. Trupi Gjykses poashtu ka përmendur se parashtrësja e fundit e avokatit të Paditësve ka qenë, në fakt, tri dite me vonesë.

Çështja se Paditësit nuk e kanë sjellë përkthimin e kërkuar të njoftimit dhënë AKP-së së datës 10 mars 2009 (shih urdhrin e 7 tetorit 2009) nuk është trajtuar në vendim.

IV

Vendimi i Trupit Gjykses i është dërguar (avokatit) të paditësve me 2 shkurt 2010.

Në ankimin e tyre, të paraqitur me kohë, me datë 25 shkurt 2010 nga (avokati i) Paditësve, është kërkuar nga Kolegji i Ankimeve të DHPGJS-së që ta anulojë vendimin dhe ta urdhërojë gjykatën e shkallës së parë që ta vazhdon procedurën. Ata argumentojnë se (përkthimi në Anglisht i autorizimit, në fakt, i ka plotësuar të gjitha kërkesat ligjore që të konsiderohet si i mjaftueshëm. Andaj, padia nuk është dashur të hedhet poshtë se e papranueshme.

Ankesa është e pranueshme dhe e bazuar.

Duke u bazuar në Nenin 63.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6 Kolegji i Ankimeve ka vendosur që të lejohet lirimi nga pjesa gojore e procedurës.

Autorizimi:

Neni 24.4 i UA-së së UNMIK-ut 2008/6 interpretohet si vijon: "Avokati që e përfaqëson palën duhet të paraqesë në Zyrën e regjistrimit një kopje të autorizimit me anë të të cilit ai autorizohet që ta përfaqësojë palën në procedurat gjyqësore pranë Dhomës së Posaçme. Dhoma e Posaçme mund të kërkojë që autorizimi i tillë të vërtetohet. "

Sipas Nenit 24.6 , lidhur me Nenet 25, 28.3 (f) dhe 28.4 të UA-së 2008/6, (përkthimi në Anglisht i) autorizimit, siç precizohet në Nenin e lart-përmendur 24.4 UA 2008/6, është njëri nga kriteret për pranueshmëri të padisë.

Trupi Gjykses mendon se autorizimi i dorëzuar nuk i plotëson këto kushte, që do të thotë se ai duhet të adresohet posaçërisht për zhvillim të procedurës para DHPGJS-së.

Nuk kontestohet- as nga vet Ankuesit- se autorizimi i dorëzuar është i përgjithshëm , i cili e autorizon [REDAKTUAR] që ti përfaqësojë Paditësit në të gjitha procedurat gjyqësore.

Përkundër qëndrimit të Trupit Gjykses, siç formulohet në vendimin e atakuar, dhe urdhrit të tyre të datës 9 nëntor 2009, megjithatë, dispozitat e paraqitura nuk kërkojnë që palët para DHPGJS-së të lëshojnë autorizim të posaçëm, për aç sa e mbulon procedurën para DHPGJS-së. Autorizimi i përgjithshëm- nga natyra e tij- parimisht përfshinë edhe DHPGJS-në (shih ASC-09-0072).

Autorizimi në rastin konkret lexohet: "Ne... me anë të kësaj ia japim këtë autorizim z. [REDAKTUAR].. që të na përfaqësojë ne para të gjitha... autoriteteve të gjykatave të Kosovës... më të gjitha lëndët civile dhe ligjore pa kufizime."Pra, autorizimi i dorëzuar (duke përfshirë përkthimin e tij në Anglisht tashmë i siguruar së bashku me padinë, dhe në vijim i plotësuar me të gjitha nënshkrimet e Ankuesve në origjinal), i përmbushë kërkesat e parashtruara me ligj; andaj, arsyetimi i dhënë nga Trupi Gjykses për hedhje poshtë të padisë mbi këto baza nuk është i vlefshëm. Në këto rrethana, paraqitja me vonesë e parashtresës së fundit është irrelevante.

Njoftimi i Agjencisë (Neni 28.2 (e) i UA-së 2008/6):

Edhe pse Trupi Gjykses nuk e ka përfshirë (më) këtë çështje në vendimin e atakuar me rastin e ankimit duhet bërë disa pasqyrime lidhur me këtë çështje:

Siç është qartësuar tashme nga e drejta precedente e Kolegjit të Ankimeve (shih ASC-09-0072, ASC -10-0027, ASC-10-0036, etj) njoftimi drejtuar Agjencisë për qëllimin e paraqitjes së padisë është njëra nga kriteret e pranueshmërisë siç përcaktohet më Nenin 28.3 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6. Edhe pse kriteri i pranueshmërisë duhet të shqyrtohet ex officio, në një fazë të hershme të procedurës (para involvimit të të Paditues) pohimi i thjeshtë nga ana e Paditësit se njoftimi i duhur është dhënë, është - parimisht- i mjaftueshëm, meqë varet nga gjykimi i lirë i së Paditues që mos ti kontestojë faktet e cekura nga Paditësi, duke përfshirë edhe çështjen e njoftimit. Andaj, duhet përsëritur edhe një herë se në qoftë se Paditësi thotë (në padi apo sipas urdhrit konform Nenit 28.4 të UA-së 2008/6) se njoftimi i duhur është paraqitur, Trupi Gjykses nuk mund ta hedh poshtë padinë si të papranueshme, në bazë të mungesës së dëshmisë se njoftimit të tillë. përveç nëse padia është e papranueshme për arsye tjera, të Paditues duhet dhenë rast që të merr qëndrim rreth njoftimit (të kërkuar), së bashku me meritën e lëndës (duke ia dërguar të paditues padinë dhe dokumentacionin tjetër; *audiatur et altera pars*). Pastaj varet nga e Paditura që ti kontestojë faktet e thëna në padi, duke përfshirë edhe siç thuhet njoftimin (e paskohshëm)., Nga Paditësi kërkohet që ta dëshmojë njoftimin vetëm nëse e Paditura (potencialisht e përfaqësuar nga Agjencia) e konteston njoftimin (e paskohshëm).

VI

Në rastin konkret, e Paditura ende nuk ka patur rast ta kontestoi njoftimi. Ndonëse, Ankuesit kanë dorëzuar një kopje (vetëm në Shqip) të njoftimit të datës 19 mars 2009 (me vulë protokollit të AKP-së të së njëjtës datë). Pa marrë parasysh çështjen e njoftimit të parë të paskohshëm (papia është pranuar nga DHPGJS në të njëjtën ditë) mund të shihet se nga 19 marsi 2009 AKP-ja ka qenë në dijeni për padinë. Që nga atëherë, ajo nuk ka zgjedhur ta zgjidh kontestin me Ankuesit. Duke patur ndërmend qëllimi i njoftimit është që ta informoi Agjencinë për paditë (e mundshme) dhe duke iu dhënë atyre mundësi që ta marrin çështjen në dorë në emër të NSH-së së involvuar (shih prap Nenin 29.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12) *ratio legis* e njoftimit në ndërkohë është plotësuar (vendimi i atakuar është marrë më 21 janar 2010, afërsisht 10 muaj më vonë). Përveç kësaj, duhet konsideruar se detyra e paditësit që ta njoftoi Agjencinë më herët shton edhe një barrë tjetër për te si dhe në qasje të drejtësisë; andaj dispozita duhet të interpretohet në mënyrë restriktive. Në këtë gjendje- dhe për aq sa njoftimi nuk kontestohet – Kolegji i Ankimeve e konsideron çështjen e njoftimit irrelevante sa i përket gjykimit të padisë (ASC-09-0072, ASC-09-0057, ASC-10-0027, ASC-10-0036, etj).

Gjithashtu, fakti se përkthimi në Anglisht i njoftimit nuk është siguruar, nuk e ndryshon rezultatit: Në urdhrin e Trupit Gjykses të datës 7 tetor 2009 Ankuesit janë nxitur që ti dorëzojnë – midis tjerash- përkthimin në Anglisht të njoftimit dhënë Agjencisë konform Nenit 29.1 të RREG së UNMIK-ut 2002/12 (lidhur me Nenin 28.2 (e) të UA-së 2008/6). Ankuesit nuk e kanë siguruar përkthimin e kërkuar, por me parashtresën e tyre të datës 29 tetor 2009 kanë paraqitur kërkesë për ndihmë në përkthim, edhe pa e përdorur formularin e duhur (për) çka nuk është vendosur nga Trupi Gjykses. Në këto rrethana njoftimi është përkthyer ex officio nga Kolegji i Ankimeve, me rezultat siç parashihet në Nenin 25.9 të UA-së 2008/6.

Kështu, hedhja poshtë e padisë si e papranueshme nuk ka qenë me vend. Andaj vendimi i atakuar nuk mund të qëndroi dhe duhet të priset. Trupi Gjykses (përsëri) duhet të merret me padinë, duke u përmbajtur nga ndonjë tjetër anulimi të saj duke u bazuar në bazat e përshkruara më lart.

Gjatë rigjykimit të padisë, Trupi Gjykses mund ta ndiej si të nevojshme që ta kërkon përkthimin e dokumenteve tjera nga Ankuesit. Sidoqoftë, para asaj kërkesë për ndihmë në përkthim mundet që të ketë (një sqarim, p.sh. duke ua sjellë atyre një formular ZPF 1 , dhe) dhe të vendoset për te.

VI

Udhëzime për paraqitje të ankimit:

Së fundi, pika 2 e vendimit të ankuar duhet të eliminohet pa zëvendësime, si udhëzime për paraqitje të ankimit duke cituar ligjin pa ndonjë liri veprimi të gjykatës, nuk ka vendime dhe kështu nuk mund të përfshihet ne diapozitiv. Informacioni i tillë mund të epet në arsyetimin ligjor ose – më mirë –vetëm ti bashkëngjitet vendimit, por nuk mund të jetë pjesë e tij. (shih ASC-09-0108, ASC-10-0036, etj).

Taksat gjyqësore/ shpenzimet

Sipas Nenit 11 të RREG 2008/4 dhe Nenit 66 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, Trupi Gjyqësor duhet të vendosë mbi caktimin e shpenzimeve të procedurës në shkallën e parë, dhe të Kolegjit të Ankimeve – kur lënda të vendoset përfundimisht- mbi caktimin e shpenzimeve procedurale në të shkallët. Kjo lëndë duhet rigjykuar ën shkallën e parë; andaj, tash për tash nuk mund të ketë vendim mbi caktimin e shpenzimeve, meqë ky caktim varet nga vendimi pasues i Trupit Gjyqësor. Tash për tash vetëm shuma e taksave gjyqësore në të dy shkallët mund të përcaktohet:

Në bazë të Nenit 57.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, Dhoma e Posaçme ka lëshuar një Rregullore Plotësuese Procedurale lidhur me Tarifat gjyqësore, në fuqi nga 10 marsi 2010. Ato interpretohet si në vijim:

“Neni 10 i Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/2 mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 27.11.2008, për “Tarifat e taksës Gjyqësore”, kësisoj- më këto precizomë- të shpallen si të zbatueshme për procedurën gjyqësore para DHPGJS-së.

Nenet 10.9, deri në 10.23 janë *-mutatis mutandis* - të zbatueshme për procedurën ankimore para Trupit Gjyqësor dhe para Kolegjit të Ankimeve.

Si sqarim, Neni 10.11. poashtu në zbatim për procedurën që rregullon ankimin kundër vendimit të shkallë së dytë të Trupit Gjyqësor.

(...)

Këto rregulla shtesë të procedurës hyjin ën fuqi me 10 mars 2010 dhe vlejnjë deri me 31 dhjetor 2010.’

VII

Taksat Gjyqësore në të dyja shkallët përbëhen në njërin anë nga një pagesë për paraqitjen e parashtresës(ave) e në anën tjetër nga një pagesë për lëshimin e vendimit (eve).

Siç u tha më lart, Trupi Gjyqësor vendosë mbi shumën e taksës gjyqësore në shkallën e parë, nën përbërje të dy komponentëve, dhe caktimin e tyre.

Sa i përket procedurës së ankimit:

Shuma e taksës për paraqitjen e ankimit siç rregullohet me Nenin 10.11 të Udhëzimit Administrativ të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Nr. 2008/2 mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore ("ADJ" është 30 Euro.

Neni 10.15 i ADJ-së përcakton se për vendimin mbi hedhjen poshtë të padive (si të papranueshme) duhet paguar vetëm gjysma e taksës siç vendoset në Nenin 10.1 të ADJ-së (i cili në parim taksat gjyqësore i bazon në vlerën e padisë) deri në maksimum in prej 30 Euro. Kjo zbatohet edhe për vendimet në shkallën e parë (Neni 10.21 ADJ i referohet Neneve 10.12 deri në 10.18 të ADJ-së) Neni 10.15, lidhur me Nenin 10.21 i mbulon vendimet në shkallën e dytë me të cilat hedhen poshtë ankimet si të papranueshme, si dhe vendimet mbi ankimet kundër vendimeve të shkallës së parë të cilat nuk e prekin meritën e lëndës.

Përveç nëse vlera e padisë dëshmohet më e vogël (në shkallën e parë nga Paditësi, në shkallën e dytë nga Ankuesi), sipas Nenit 10.1 lidhur me Nenin 10.15 dhe 10.21, taksa gjyqësore është 30 Euro.

Në rastin konkret, në shkallën e parë deklarimi sa i përket vlerës së padisë është dhënë (150,000 Euro). Taksa Gjyqësore për vendimin në shkallën e dytë pra është 30 Euro.

Si rrjedhim, për procedurën e ankimit zbatohen këto taksa gjyqësore:

Tarifa e Taksës Gjyqësore, Neni 10.11 (parashtrimi i ankesës)..30 Euro

Tarifa e Taksës Gjyqësore Neni 10.15 lidhur me 10.21 dhe 10.1
(vendimi në shkallën e dytë)..... 30 Euro
Gjithsej.....60 Euro

VIII

Taksat gjyqësore i vihen paraprakisht në barrë Ankuesve të cilët janë (bashkarisht të obliguar të paguajnë shumën e lart-cekur në Dhomën e Posaçme (shih Nenin 2 (1) të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, Gazeta Zyrtare e Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës së datës 3 tetor 1987).

Bie në Trupin Gjyqësor që ti caktoi këto shpenzime të procedurës ankimore midis palëve, së bashku me vendimin e shkallës së parë, përfshirë edhe vendimin e shpenzimeve (të ardhshme) gjyqësore të shkallës së parë.

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues, EULEX (nënshkrimi)

Torsten Frank Koschinka, Gjyqtar, EULEX (nënshkrimi)

Elija-Liisa Helin, Gjyqtare, EULEX (nënshkrimi)

Tobias Lapke, Regjistruar, EULEX (nënshkrimi)